



Arsimimi gjatë pandemisë!

Nga Alina Nikqi

Nuk ka fjalë të cilat mund ta pershkruajnë atë kohë të vështirë, ishte një kohë të cilën po e perjetonin të gjithë ne menyrën më të keqe të mundshme. Fëmijët ishin të detyruar të mësonin përmes telefonave, kompjuterave, televizionave. Natyrisht që askush nuk do donte ta perjetonte atë, por ishim të detyruar, kudo që shkoje nuk duhet harruar maska, doreza, dezinfektuesi si dhe distanca që duhet mbajtur. Në qoftë se e hapja televizionin, pendohesha, doja të qaja, ajo dhimbje kur dëgjoja se çdo ditë po vdesin njerëz, çdo ditë po shtoheshin rastet me Covid-19, sa dhimbje. Ah, ajo dhimbje kur shikoje se sa keq po perjetohet ajo periudhë, kur nuk mund të shkoje në shkollë për semundjen që kishte kapluar të gjithë botën.

Pas një kohe të gjatë ne u kthyem në shkollë, ajo ndjesi ishte një ndjesi e papershkrueshme, ajo ndjesi kur shikoje shokët dhe shoqet e klasës pas një kohe, kur shikoje mesimdhënësit duke e dhënë maksimumin të kompenzojmë atë pjesë të cilën nuk e kishim të qartë gjatë mësimin online. Edhe përse buzëqeshjet nuk i shikoje tek fytyrat e fëmijëve, jo sepse ata nuk buzëqeshnin por nga maskat, ua dalloje sytë që ju shkelqenin, vraponin nga lumturia, ishin më të gatshëm se kurrë të mësojnë. Natyrisht se mësimi online kishte ndikuar negativisht edhe në shëndetin mendor tek fëmijët, ndoshta tek kjo ka ndikuar edhe nga mos kujdesi i prindërve, e urrej faktin që pas çdo lajmi të keq në lidhje me situatën e pandemisë, diskutoheshin në prezencë të fëmijëve, më pas fëmijët stresoheshin dhe e përjetonin ende më rëndë atë situatë, kjo gjë ka ndikuar në shëndetin e fëmijëve. Kishte ardhur një kohë kur në qoftë se kolliteshe të gjithë të shikonin sikur të ishe përbindësh. Qyteti ishte i shprazët, vetëm policët gjendeshin çdo kund nëpër rrugë. Ishte e vështirë të dilje deri në dyqan, e lëre më të shkoje në shkollë.

Shkollat fillore mësonin përmes televizionit, do të ishte shumë më e lehtë dhe më e kuptueshme ndoshta jo për ciklin e ulët (kl.1-5), por për ciklin e lartë (kl. 6-9) sikur të mësonin me aplikacionin zoom, për arsye se do të ishte shumë më e qartë dhe në qoftë se do të ju parashtrohej një pyetje atëherë do të ishte më pak e komplikuar në qoftë se do komunikonin përmes zoomit!



Përderisa po spjegohej mësimi në televizion edhe pse po spjegohej në mënyrë shumë të mirë, nuk po tregohej interes nga fëmijët, nuk po tregohej interes për të marrë informata të cilat janë të nevojshme dhe do duheshin zbërthyer patjetër në qoftë se do sqaroheshin në shkolla apo përmes zoomit. Nuk duhet harruar edhe fakti që shumë fëmijë që ndoshta kanë shpreh interes për të mësuar por paisja me mjetet konkrete që e mundësojnë mësimin online mungon, qoftë tabletët, televizioni apo edhe mjetet shkollore. Është edhe fakti që mentaliteti i prindërve nuk e lejon që fëmija të shkojë tek ndojnë psikolog, që mendoj se është e domosdoshme për 85% të fëmijëve të jenë konsultuar me psikologët!

Prindërit nuk i konsultojnë fëmijët e tyre me psikologë dhe nuk i lejojnë të vaksinohen dhe më pas ndahen të zhgënjyer se si fëmijëve nuk po u mundësohet arsimimi në mënyrë të rregullt! Shtrohet pyetja se përse fëmijët janë egërsuar gjatë periudhes së pandemisë, eh po përgjigjja është e ditur, moskujdesi i prindërve apo kujdestarëve ligjorë, moskonsultimi me psikologët. Prindërit apo kujdestarët ligjorë duhet patjetër të ju japin kurajo, ti mbështesin fëmijët. Gjithashtu edhe shkollat në të cilat u mundësua mësimi fizik duhet të jenë të paisura me psikologë/terapistë ku fëmijët mund të paraqesin problemet që i kanë me veten e tyre. Fëmijëve sidomos në shkolla fillore nuk iu mjafton vetëm të kenë nje kuti ankesash ku mund ti adresojnë problemet që kanë me klasën apo me shkollën, iu duhet dikush që mund ti kuptojë edhe me problemet me veten e tyre apo edhe me problemet që nuk kanë të bëjë me shkollën.

Ne si fëmijë shpresojmë që kjo situatë të qetësohet sa më parë, prinderit apo kujdestarët ligjorë të tregohen më të kujdesshëm në lidhje me shëndetin mendorë të fëmijëve. Gjithashtu edhe masat mbrojtëse të mos i harrojmë, Corona është akoma këtu, Corona po merr akoma jetë! Mbroje vetën, mbroj shoqërin, mbroj familjen me disa hapa shumë të thjeshtë: Mos e harro maskën! Mbjaj distancën!